

UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES IN FERIZAJ

Nr. Prot. 1855/22	Nr. Prot. 1855/22
Org. Unit 1	Org. Unit 1
Nr. I faqes 3	Nr. I faqes 3
Data: 27.05.2022	Data: 27.05.2022

NUMERA SHKUTIT: 02/3815

Nr. i Prot. 02/3815	Nr. i Prot. 02/3815
Nr. i Faq. 3	Nr. i Faq. 3
Data: 27.05.2022	Data: 27.05.2022

UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT TË SHKENCAVE TË APLIKUARA FERIZAJ

DHE

KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

Kjo Marrëveshje është lidhur, me datën 27.05.2022.

Baza Juridike :

1. Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtaret Publike Neni 34, Parag. 12.
2. Rregullore (QRK) Nr. 16/2020 për Pranim dhe Karrierë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Neni 18 Parag. 2.3.

Neni 1

Palët e Marrëveshjes

Marrëveshja e Bashkëpunimit (në tekstin e mëtejshme Marrëveshje) lidhet mes Komunës së Hanit të Elezit, e përfaqësuar nga Kryetari z. **Mehmet Ballazhi** dhe Universitetit të Shkencave të Aplikuara Ferizaj, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Agron Bajraktari.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është të përcaktojë kushtet e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve për interesin reciprok.

Neni 3

Obligimet e palëve të Marrëveshjes

Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj obligohet të ofrojë një listë me emrat e stafit akademik dhe profesional, si dhe profesionin e tyre me qëllim që Komuna e Hanit të Elezit të evidentojë nga lista ekspertin adekuat, i cili do të jetë pjesë e Komisionit për pranim në Shërbimin Civil.

Neni 4

Përcaktimi i modaliteteve të Marrëveshjes

Komuna e Hanit të Elezit dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj pajtohen që në bashkëpunim të caktojnë ekspertin, i cili do të jetë pjesë e Komisionit për pranim në Shërbimin Civil, vlerësim-intervistim të kandidateve.

Neni 5

Kompensimi i punës së ekspertëve

Komuna e Hanit të Elezit dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj pajtohen që eksperti/professori i caktuar do të ketë pagesë fikse 250 € (dyqind e pesëdhjetë euro), sipas legjislacionit në fuqi, që paguhet për secilën procedurë të konkurrit për ekspertin e angazhuar.

Neni 6

Mënyra e kompensimit të ekspertëve

Shuma e përcaktuar sipas nenit 5 të kësaj kontrate kryesit të punës do t'i paguhet nga kategoria "Mallra dhe Shërbime".

Neni 7

Detyrimet e ekspertëve

Palët e Marrëveshjes pajtohen që eksperti i përzgjedhur të jetë prezentë në Komision për pranim në datën dhe orën të cilën e cakton Kryetari i Komisionit për Pranim në Komunën e Hanit të Elezit.

Neni 8

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Marrëveshja ka afat vlefshmërie bashkëpunimi për periudhën dy vjeçare, me mundësi vazhdimi, plotësim ndryshimi me pajtimin e dy palëve.


Neni 9
Hyrja në fuqi

Marrëveshja e bashkëpunimit hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të palëve.

Neni 10
Dispozitat përfundimtare

Marrëveshja e bashkëpunimit është e nënshkruar ne 2 (dy) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI


Rektor i Universitetit të
Shkencave të Aplikuara të Ferizaj



Z. Mehmet BALLAZHI


Kryetari i Komunës

